

LIGJ
Nr.10 483, datë 17.11.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9251, DATË 8.7.2004 “KODI DETAR I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë detare, të përcaktuara në shkronjën "a" të nenit 8 të këtij ligji, përfshihen në kategorinë VII.4 të ligjit për licencat, ndërsa veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “b”, “ë”, “f” dhe “g” përfshihen në kategorinë VII.5 të ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas dispozitave në vijim, të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 22, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Mjetet lundruese me flamur shqiptar, si edhe ato me flamur të një shteti të Bashkimit European mund të kenë pikënisje dhe destinacion të brendshëm në çdo port shqiptar e të huaj, kur plotësojnë kërkesat ligjore.

2. Mjetet lundruese me flamur të huaj, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 1 të këtij neni, lundrojnë vetëm ndërmjet një porti shqiptar dhe atij të huaj.”.

Neni 3

Në nenin 136, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kapiteni i anijes shqiptare duhet të jetë me shtetësi apo kombësi shqiptare ose shtetas i një shteti të Bashkimit European.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7173, datë 1.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi